ΠΑΝΕΠΙΣΤΗΜΙΟ ΙΩΑΝΝΙΝΩΝ
ΑΡΧΕΙΟ ΕΥΛΟΓΙΟΥ ΚΟΥΡΙΛΑ
Αρ. Εγγρ.: 21150

Tirane, 26 Korrik 1939

26/7

Fort i ndershem im Lengj,

Jemi shendosh' e mire te gjithe te shtepis dhe me anen t'ime ju puthim doren e shenjte. Viktoria ardhi dhe esht shum e kenaqur nga mirësia e juaj. Ajo me solli edhe lajmin se nuk do te vini ne Greqi; gofte per te mire (κάθε εμπόδιο γιά καλό). – filosofiâ e jetes ia ka gjetur fjalen ngushellonjese çdo rasti...

Tani esht nevoje te mejtonj bashke me juve mbi çeshtjen e Violetes, mbasi esht e vertetuar mê qe interesohi per ate aqe sa edhe une vete dhe gjendjâ e re na detyron te mejtojme si do te sigurohet vashdimi. Kisha nder mend t'ju-a parashtronja kete çeshtje po te vinit ne Athine, po me qene se nuk vini, po ju-a shkruanj se mund te rregulloni diçka me anen e Dhiakut. Pra, siç duket puna,

ΠΑΝΕΠΙΣΤΗΜΙΑΚΗ ΒΙΒΛΙΟΘΗΚΗ ΙΩΑΝΝΙΝΩΝ

pasketaj do te jete shume zor qe t'i dergojme te holla prej ketej dhe ndofta e pamundur. Dy heret e fundit qe i dergova mezi e rregullova. Prandaj, do t'ish mire, mbasi e muarte per siper te m'a beni kete ndihme-miresi, qe t'i derthte te hollat Dhiaku qe tani sa ndodhet andej, ose t'i lere ne nonje dore ku t'a shihni t'arsyeshme. Do t'ish me mire, kujtonj, qe te vashdonte ne Οἰκοτροφεῖον Σχολῆς Καλλιθέας, q'esht me e plote, por duhesh njeri atje dhe esht pak me shtrejt. Ne te Selenikut duhen 1400 Dr. per Οἰκοτροφεῖον dhe 200 Dr. per shkollen, te tera 1600 Dr. ne muaj, perveç ç'do t'i duhen per veshje dhe per ἐργόχειρα etj. Ju lutem ~~kam~~ miresine t'a mejtoni edhe ju kete pune dhe te me njoftoni perfundimin. Mjerisht, s'mund te largohem qe te vinj gjer Korçe.

Nga ana tjater, per punen

e bursës për vajzën e vogël, Sofinë.
Legata këtu më ka thënë se
është e mbaruar, d. m. th. na kanë
dhënë fjalën dhe kanë shkruajtur
ka tashi afër një muaj, për të
marrë vërtetimin nga Athina.
(Më kanë thënë edhe Nr. e shkresës
që të mund t'a ndjekim n' Athinë,
në Ministri dhe po na dërgoj juve
këtu mbyllur, se mund t' ia dërgoni
ndonjë mikut). Për këtë ju kish shkruajtur
edhe juve Dragumi vitin e kaluar.
Me qenë se u nis kejo udhë duhet
t' a ndjekim me gjith që kam dyshim
se vallë do t' a nisim dot që këtej
gruppen. Për mua sot për sot është më
me rëndësi puna e tjatrës që e nisi
andej dhe duhet të vazhdojë.

Më falni se po ju mbaj kaq gjatë
me këto halle të mia, por e bëj se
jam i siguruar për interesimin t'uaj
atnor dhe se ... më shtrëngon nevoja.

Ndonjë të re të përmendëshme s'kam
t' ju jap. Punët t'ona me Kisin më duket
se janë shtruar tashi, si edhe në vend
atje. Po të kini ndonjë porosi më shkruani.
Vapë kemi patur të padurueshme, tashi ka

./.

dy dit që ara e nxehta, se ment t'a zuri frymen. Miqve te fala,

Ju puth doren

Vasili

ΠΑΝΕΠΙΣΤΗΜΙΑΚΗ ΒΙΒΛΙΟΘΗΚΗ ΙΩΑΝΝΙΝΩΝ